NJOFTIM PUNËSIMI	
Prezantimi i Shoqërisë Rajonale UK	Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Rajoni Durrës është themeluar më 31.08.2022 sipas VKM nr. 302, dt. 11.05.2022 "Për Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura". Shoqëria Rajonale UK është një institucion profesional i licencuar për ofrimin e shërbimeve bazike të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve. Ajo i shërben bashkisë Durrës, Shijak, Kavajë, Rrogozhinë dhe Krujë. Aktualisht Shoqëria Rajonale UK po kërkon të punësoj për një vend pune: Përgjegjës i Grumbullimit të Ujërave Ndotura në Njësinë Operative Krujë nisur nga data më e afërt.Punëmarrësi i ri organizon, koordinon dhe drejton punën e njësisë, nëpërmjet shpërndarjes së detyrave, kërkesës së llogarisë, marrjes së masave dhe paraqitjes së propozimeve.
Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:	• Mban përgjegjësi për operimin e sistemeve të grumbullimit dhe largimit të ujërave ndotura si dhe për menaxhimin e ujërave të ndotura në zonat që nuk mbulohen me kanalizime. • Kryen shpërndarjen e fuqisë punëtore, të mjeteve dhe makinerive teknologjike, sipas planit paraprak të miratuar nga Përgjegjësi i Sektorit Teknik dhe sipas situatave emergjente. • Bën porositë e materialeve, pajisjeve dhe makinerive të nevojshme për realizimin e punës si dhe nënshkruan dokumentacionin për sigurimin dhe tërheqjen e bazës materiale që kërkohet për zbatimin e punimeve dhe për vënien në dispozicion të makinerive teknologjike për kryerjen e punimeve. • Harton librezën e masave dhe situacionin e punimeve që kryhen. • Përgatit raporte (ditore/javore/mujore) për punimet e mirëmbajtjeve të realizuara. • Mban një regjistër të posaçëm për defekte, bllokime dhe shkarkime të palejuara në sistemin e kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe afatet e përfundimit të tyre.

	• Zbaton procedurat e operimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të kanalizimeve dhe stacioneve të tyre të pompimit. • Merr masat për evidentimin dhe eliminimin e shkarkimeve të ndaluara në sistemet e kanalizimeve.
Kualifikimet e synuara dhe dokumentacioni:	• Eksperienca pune të mëparshme. • Librezë e Punës • Certifikatë Familjare • Fotokopje e Kartës së Identitetit, Pasaportës • Dy fotografi • Fotokopje e Dëftesës me listën e notave e noterizuar • Dëshmi Penaliteti • Raporti Mjekësor • Vërtetim Vendbanimi
Kushtet e punës:	• Mundësinë për të punuar në një kompani të ngritur. • Mundësinë për të krijuar eksperiencë në kompani.

- Nëse jeni të interesuar dhe besoni se ju përmbushni të gjitha kërkesat për pozicionin e punës, ju lutemi aplikoni me letër përcjellëse, CV-në dhe dëshmi të kualifikimeve arsimore dhe profesionale (diplomë, certifikata, etj.) deri më datë 02.12.2026, pranë Protokollit të Dr.Përgjithshme Shoqërisë UK.Rajoni Durrës. Për çdo pyetje/paqartësi, ju lutemi kontaktoni në emailin zyrtar.